

20220270292

**АГЕНЦИЈА ЗА СУПЕРВИЗИЈА НА КАПИТАЛНО ФИНАНСИРАНО ПЕНЗИСКО
ОСИГУРУВАЊЕ**

Në bazë të nenit 100 të Ligjit të Sigurimit Pensionsal Vullnetar me Financim Kapital (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 7/2008, 124/2010, 17/2011 dhe 13/2013 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 103/2021), Këshilli i Ekspertëve i Agjencisë së Mbikëqyrjes të Sigurimit Pensionsal me Financim Kapital, në seancën e mbajtur më datë 27.1.2022, miratoi

**R R E G U L L O R E
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR MËNYRËN E
PAGESËS SË KONTRIBUTEVE NË FONDIN PENSIONAL VULLNETAR**

Neni 1

Në Rregulloren për mënyrën e pagesës së kontributeve në fondin pensionsal vullnetar (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 138/2008) në nenin 8, paragrafi (2) pas fjalës “pagesi” shtohen fjalët: “edhe përmes transaksionit lidhur me llogarinë transaksionale të anëtarit dhe/ose pagesit”.

Neni 2

Në nenin 12, paragrafi (2) pas fjalës: “siguruesi” shtohen fjalët: “ose përmes transaksionit lidhur me llogarinë transaksionale të siguruesit”.

Neni 3

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e ardhshme nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr.01-110/3
31.1.2022
Shkup

Kryetari i Këshillit të
Ekspertëve,
Maksud Ali, d.v.